

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6254  
E mërkurë, 3 mars 2021  
çmimi 0.40 €

## Protestohet kundër "uzurpimit të vendeve të garantuara" në Kuvendin e Kosovës

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAQIR TOTAJ | FAQE 4-5

## ASKUSH NË PDK NUK I IK LLOGARIDHËNIES PËR REZULTATIN



Nënkrjetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj, ka thënë se askush brenda partisë nuk i ik llogaridhënies për rezultatit të zgjedhjeve të 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kjo parti është duke i analizuar shkaqet që kanë çuar në këtë rezultat. Totaj ka theksuar se pas përfundimit të analizës do të nxjerrin edhe rekomandime për të parë se si do të veprojnë në të ardhmen. Ai ka treguar se do të jetë kandidat i PDK-së për kryetar të Prizrenit, duke u shprehur i bindur se do ta rikthejë qeverisjen e PDK-së në këtë qytet.

PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN, MIROSLAV LAJÇAK, KA TAKUAR PËRFAQËSUESIT E INSTITUCIONEVE DHE LIDERËT E PARTIVE POLITIKE | FAQE 3

## LAJÇAKU KËRKON UNITET TË BRENDSHËM PËR DIALOGUN

Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, ka thënë të martën në Prishtinë, se pret që marrëveshja gjithëpërfshirëse Kosovë - Serbi të arrihet brenda mandatit të qeverisë Kurti 2. Ai ka thënë se pret që klasa politike në Kosovë të jetë unike në këtë drejtim dhe ta kuptojë rëndësinë e dialogut me Serbinë.



BESËLIDHJA E  
LEZHËS BËN BASHKË  
SHQIPTARËT NGA  
KOSOVA, SHQIPËRIA,  
MALI I ZI,  
MAQEDONIA DHE  
LUGINA | FAQE 8

### AKTUALE



GRENELLI I REAGON KURTIT,  
E QUAN ANTIAMERIKAN | F. 5

TETË TË VDEKUR DHE  
488 RASTE TË REJA ME COVID  
NË KOSOVË | F. 6

BEQIRI: ZGJEDHJET  
E BRENDSHME NË LDK  
MOS TË KONTROLLOHEN NGA  
KRYESIA E PARTISË | F. 7

### EKONOMI



SAMI MAZREKU EMËROHET  
DREJTOR I BYROSË KOSOVARE  
TË SIGURIMIT | F. 9

PROCEDOHET PAGESA  
PREJ 3 MILIONË EUROSH  
PËR "TREPÇËN" | F. 9

### SPORT



BATATINA: LLAPI  
NËPËRMJET KUPËS SIGURON  
DALJEN NË EVROPË | F. 13

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Sofja akuzon Shkupin për shkeljen e të drejtave të pakicës bullgare

**SOFJE, 3 MARS** - Ministrja e Punëve të Jashtme e Bullgarisë, Ekaterina Zaharieva, ka kritikuar autoritetet maqedonase për shkeljen e të drejtave të pakicës bullgare, që jeton në Maqedoninë e Veriut, duke theksuar se “është e papranueshme që në Maqedoninë e Veriut, në shekullin 21, të mos njihet e drejta e vetëvendosjes”. “Ne reagojmë në çdo rast dhe shpresojmë që të mos ndodhë më. Mbi 100 000 qytetarë kanë shtetësi bullgare dhe nganjëherë frikësohen të deklarohen. Është e papranueshme që në shekullin 21 të mos njohësh të drejtën e vetëdeklarimit”, ka thënë të martën shefja e diplomacisë bullgare në një intervistë për televizionin shtetëror bullgar (BNT). Duke folur për politikën bullgare

ndaj Maqedonisë së Veriut, Zaharieva ka thënë se Bullgaria ka një politikë të qëndrueshme ndaj Shkupit dhe ka kërkuar drejtësi për bullgarët që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. “Ne jemi shumë konsistentë në politikë. Disa njerëz atje ishin shumë të befasuar që i thamë ‘jo’ kornizës së negociatave [midis Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian]. Sidoqoftë, pozicioni i Bullgarisë është i njëjtë që nga viti 2019. Ne besojmë se ka një përmbushje të ngadaltë ose mungesë të përmbushjes së detyrave nga pala maqedonase sa i përket Marrëveshjes së Fqinjësisë së Mirë me Maqedoninë e Veriut. Më parë kishte lëvizje në të gjitha sferat, por që nga fillimi i vitit 2019, kur u bënë anëtar i NATO-s, ka gënjecje për përmbushjen e obligimeve”,



ka deklaruar Zaharieva. Deklarata e saj ka ardhur pas një takimi të presidentit bullgar Rumen Radev dhe krerëve të shërbimeve të sigurimit të Bullgarisë për, siç është thënë, “mbrojtjen e pakicës bullgare në Maqedoninë e Veriut”. Kreu i shtetit bullgar ka thënë

se “institucionet duhet të marrin masa me kohë për t’i mbrojtur në mënyrë adekuate të drejtat e shtetasve bullgarë jashtë vendit, kur ata sulmohen vetëm për shkak të vetëdijes së tyre kombëtare”. Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, i ka mohuar akuzat e Sofjes, duke

theksuar se “askujt në vend nuk i janë shkelur të drejtat, madje as qytetarëve që deklarohen si bullgarë”. “Edhe pse në Kushtetutë nuk kemi bullgarë etnikë, të gjithë mund të përcaktohen për regjistrimin e popullsisë, sepse pyetja do të jetë se cilës bashkësi etnike i përkisni. Ne jemi një komunitet shumetnik, ne i respektojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në vend, madje edhe të atyre më të vogla”, ka deklaruar Zaev, duke i komentuar akuzat e palës bullgare.

Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria i kanë ftohur raportet që nga nëntori i vitit të kaluar, kur Bullgaria e ka bllokuar kornizën e negociatave midis Maqedonisë së Veriut dhe BE-së, deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me gjuhën, identitetin dhe aspektet historike.

## Rregullat e gjyqësorit në Poloni “mund ta shkelin ligjin e BE-së”

**VARSHAVË, 2 MARS** - Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka vendosur të martën që rregullat e reja të Polonisë, për emërim të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme, mund ta shkelin Ligjin e Bashkimit Evropian. Ky vendim obligon qeverinë e krahut të djathtë të Polonisë që të mos zbatojë këto rregulla dhe t’i respektojë parimet e gjyqësorit të pavarur dhe të të drejtës për mbrojtje gjyqësore. Bashkimi Evropian ka kritikuar ashpër qeverinë konservatore polake për ndryshimet që ka bërë në gjyqësor, prej kur ka marrë pushtetin më 2015, duke thënë se ato e dëmtojnë

sundimin e ligjit. Legjislacionet në Poloni kanë fuqizuar ndikimin politik ndaj Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit dhe procedurën se si bën ky trup emërimet në Gjykatën Supreme. Në kuadër të ndryshimeve është përfshirë edhe kufizimi i së drejtës për t’i apeluar vendimet e këshillit. Rregulloret “të cilat kanë efektin e largimit të rishikimit të efektshëm gjyqësor të vendimeve të këshillit... (propozimit) të kandidatëve si gjyqtarë në Gjykatën Supreme mund t’i shkelin ligjet e BE-së”, ka thënë Gjykata Evropiane për

Drejtësi në vendimin e saj. Shumë anëtarë të gjyqësorit në Poloni e kanë mirëpritur këtë vendim. “Gjykata Evropiane ka vënë limite në fuqinë politike”, ka thënë avokatja Marcjanna Debska. “Ajo nuk u referohet vetëm vendimeve, por edhe situatës politike, dhe kjo nënkupton se gjykata mund ta shohë qartë se çfarë po ndodh në Poloni”. Mirëpo një anëtare e partisë në pushtet Ligji dhe Drejtësia, avokatja Krystyna Pawlowicz, e ka kritikuar vendimin, duke thënë se “nuk ka bazë ligjore dhe është kundër sistemit ligjor të Polonisë.



## ShBA-ja sanksionon shtatë zyrtarë rusë pas helmimit të Navalnyt



**UASHINGTON, 3 MARS** - Shtetet e Bashkuara kanë thënë se do t’i sanksionojnë shtatë pjesëtarë të qeverisë ruse si përgjigje ndaj helmimit dhe burgosjes së liderit opozitar rus Aleksei Navalny. Uashingtoni ka thënë më 2 mars se do të vendosë kufizime të eksportit ndaj nëntë subjekteve komerciale brenda Rusisë, të cilat janë të përfshira në kërkimet biologjike dhe ato kimike. Një zyrtar i lartë amerikan ka thënë gjatë njoftimit se ShBA-ja

ka rënë në përfundim dhe “beson shumë” se zyrtarët rusë kanë qenë mbrapa helmimit të Navalnyt në gusht. Shtetet e Bashkuara kanë thënë se do të publikojnë edhe emrat e shtatë individëve më vonë gjatë ditës. Sipas një zyrtari amerikan Shtetet e Bashkuara do të përgjigjen në javët në vijim “për një numër të veprimeve destabilizuese” të Rusisë, duke përfshirë hakimet në kompaninë softuerike “Solar Winds” dhe shpërblimet për

vrasjen e amerikanëve në Afganistan. Navalny, 44-vjeçar, udhëheqës i Lëvizjes Kundër Korrupsionit dhe kritiku më i madh i presidentit rus Vladimir Putin, është arrestuar më 17 janar, pasi është kthyer nga Gjermania, ku është trajtuar për pesë muaj që nga helmimi me agjent nervor. Ai beson se urdhri për helmim është dhënë nga Putini. Autoritetet ruse, në anën tjetër, hedhin poshtë akuzat.

Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, ka takuar përfaqësuesit e institucioneve dhe liderët e partive politike

## Lajçaku kërkon unitet të brendshëm për dialogun



Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, ka thënë të martën në Prishtinë, se pret që marrëveshja gjithëpërfshirëse Kosovë - Serbi të arrihet brenda mandatit të qeverisë Kurti 2. Ai ka thënë se pret që klasa politike në Kosovë të jetë unike në këtë drejtim dhe ta kuptojë rëndësinë e dialogut me Serbinë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 MARS - Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, ka thënë të martën në Prishtinë se pret që marrëveshja gjithëpërfshirëse Kosovë - Serbi të arrihet brenda mandatit qeverisës të Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit. "Besoj se mund ta përfundojmë këtë proces me një marrëveshje gjithëpërfshirëse gjatë mandatit të z. Kurti dhe znj. Osmani. Nuk shoh pengesa në këtë rrugë", ka thënë Lajçak.

Pas një takimi me ushtruesen e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, ai ka thënë se edhe BE-ja pret zbatimin e programit elektorale të kreut të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe Osmanit, por se partnerët ndërkombëtarë, BE-ja dhe ShBA-ja, presin edhe vazhdimin e dialogut. "E kam thënë edhe në të kaluarën dhe e po e përsëris, ky proces do të mund të përfillojë brenda disa muajve. Pra, nuk duhen vite që të arrihet marrëveshja. Por, në nuk jemi ata që po nxitojmë ose ata që e ngadalësojnë procesin. Janë Kosova dhe Serbia që vendosin se sa shpejt duan të procedojnë.

Nëse duan të takohen çdo muaj, ne jemi aty. Nëse duan të takohen çdo javë, ne jemi këtu për të ndërmjetësuar dhe nuk na duhen edhe dhjetë vjet të tjera, as pesë vjet të tjera, as tre vjet, nëse ka përkushtim dhe vullnet të palëve", u shpreh Lajçak.

Ai ka thënë se pret që klasa politike në Kosovë të jetë unike në këtë drejtim dhe ta kuptojë rëndësinë e dialogut me Serbinë. Lajçak i siguroi liderët e Kosovës se procesi i dialogut është në koordinim të plotë me Shtetet e Bashkuara. "Jam i lumtur të them se pas ardhjes së administratës (së presidentit amerikan, Joe) Biden, ky bashkëpunim nuk mund të jetë më i ngushtë sesa është. Ne po punojmë ngushtë me partnerët tanë amerikanë dhe miqtë dhe ne e ndajmë qëllimin e njëjtë që është e ardhmja evropiane për Kosovën dhe për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor", është shprehur Lajçak.

Ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, e cila garoi në listën e Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se institucionet e reja do të angazhohen në dialog, por me një qasje të re, e cila, sipas saj, synim kryesor do ta ketë trajtimin e barabartë në dialog dhe njohjen

e ndërsjellë si akt final. "Qasja e re nënkupton që ne assesi nuk mund ta pranojmë që çështja e kufijve, sovraniteti, rregullimi kushtetues i Kosovës të bëhen pjesë e negociatave sepse ato negociata kanë përfunduar në vitin 2008, nën mandatin e Ahtisartit. Kosova ka bërë shumë koncesione, sa e kanë sjellë buzë jofunksionalitetit. Nuk është tema se çfarë mund të japë sërish Kosova, por se si BE-ja mund t'ua japë përfitimin Kosovës dhe Serbisë për anëtarësim në BE", ka deklaruar ajo.

Osmani ka thënë se ka kërkuar nga Lajçaku që pas konstituimit

të institucioneve të reja, t'u ofrohen të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në kuadër të dialogut dhe të shihet se në çfarë faze janë zbatuar ato dhe çfarë mund të bëhet.

Pas takimit me Osmanin, Lajçak është takuar me kryeministrin në detyrë, Avdullah Hoti. Sipas njoftimit për media, Hoti e ka falënderuar Lajçakun për bashkëpunimin e deritanishëm në ndërmjetësimin e dialogut dhe "i ka dëshiruar sukses në finalizimin e këtij procesi", thuhet në njoftimin për media të zyrës së Hotit.

Miroslav Lajçak arriti të hënën në Kosovë. Takimin e parë me

lidërshpinin e Kosovës e zhvilloi me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, partia e të cilit i ka fituar zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit në Kosovë. Kurti, pas fitores, ka thënë se dialogu me Serbinë nuk është në mesin e prioritetëve kryesorë të qeverisë që ai mëton ta udhëheqë. Pas takimit të së hënës me përfaqësuesin e posaçëm të BE-së, Kurti deklaroi se nuk e mohon rëndësinë e dialogut me Serbinë, por shtoi se ai duhet të jetë i përgatitur mirë dhe i sinqertë. Kurti tha se "nuk është në presion të kohës" dhe nuk dha datë se kur mund të rifillojë dialogu.

## Lajçaku takon edhe Hoxhajn, Mustafën dhe Haradinajn

Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, është takuar edhe me liderin e PDK-së, Enver Hoxhaj. Ky i fundit e ka njoftuar Lajçakun për qëndrimin e PDK-së që çfarëdo marrëveshje e mundshme në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e vendit, të mos e cenojë tërësinë territoriale, integritetin dhe sovranitetin e Kosovës. Sipas Hoxhajt, rajoni mund ta tejkalojë këtë sfidë historike vetëm kur të dyja vendet e njohin njëra-tjetrën dhe Kosova siguron ulëse në OKB. Po në takim kryetari Hoxhaj ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me

hartën e paraqitur nga Lajçaku në njërin prej intervistave të tij ku nuk figuronte kufiri i Kosovës si vijë ndarëse me Serbinë. Hoxhaj ka kërkuar nga Lajçaku një kërkimfalje për këtë çështje, meqë ndërmjetësuesi i dialogut nuk duhet të ketë qëndrim të njëanshëm në këtë proces dhe ai duhet ta njohë realitetin e Kosovës së pavarur.

Lajçaku është takuar edhe me liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se dialogu me Serbinë duhet të përfundojë me njohjen reciproke. "Ripërsërita qëndrimet tona për dialogun, domosdoshmërinë e rolit strategjik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

përkushtimin tonë për një Marrëveshje Gjithëpërfshirëse Ligjërish të obligueshme, e cila ka epilog njohjen reciproke në kufijtë ekzistues dhe respekton rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Bashkërisht vlerësuam zgjedhjet e 14 shkurtit si fitore për demokracinë dhe theksuam nevojën e konstituimit të institucioneve të reja në afat sa më të shpejtë. Lajçakun e falënderova për angazhimin e tij dhe të Bashkimit Evropian në këtë proces të rëndësishëm për vendin tonë", ka thënë Haradinaj. Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun ka takuar edhe liderin e LDK-së, Isa Mustafa.



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAQIR TOTAJ

## Askush në PDK nuk i ik llogaridhënies për rezultatin

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj, ka thënë se askush brenda partisë nuk i ik llogaridhënies për rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kjo parti është duke i analizuar shkaqet që kanë çuar në këtë rezultat. Totaj ka theksuar se pas përfundimit të analizës do të nxjerrin edhe rekomandime për të parë se si do të veprojnë në të ardhmen. Ai ka treguar se do të jetë kandidat i PDK-së për kryetar të Prizrenit, duke u shprehur i bindur se do ta rikthejë qeverisjen e PDK-së në këtë qytet

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 MARS - Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj, ka deklaruar se kjo parti është duke i analizuar shkaqet që kanë çuar në rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Ai ka treguar se pas analizës, kjo parti do të dalë edhe me konkluzione konkrete për të ardhmen. Në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re", Totaj ka thënë se askush në parti nuk i ik llogaridhënies për rezultatin e arritur në këto zgjedhje. "Ne aktualisht jemi në proces të

analizave të shkaqeve, pastaj do të kemi edhe konkluzione si dhe rekomandime se si do të veprojmë në të ardhmen. Ajo që mund të them tani është se askush brenda partisë nuk i ik nga llogaridhënia, por ne aktualisht po e bëjmë identifikimin e fushave ku kemi mundësi për përmirësim, me qëllim të ngritjes së performancës e jo me qëllim të kërkimit të përgjegjësive, aq më pak në një kontekst të fjalës 'përgjegjësi' e cila, ndoshta, t'i kujton kohët e kaluar!", ka thënë Totaj. Nënkryetari i PDK-së ka bërë me dije se të gjitha diskutimet

brendapartiake kanë për qëllim avancimin dhe ngritjen e PDK-së. "Diskutimet brenda forumeve partiake zhvillohen me tone pozitive dhe konstruktive. Në kuptimin e plotë të fjalës ne jemi kritikë ndaj vetes, por vetëm në drejtim të identifikimit të proceseve dhe dukurive negative", është shprehur ai. Totaj, i cili është kryetar i Degës së PDK-së në Prizren, ka treguar se ai do të jetë kandidat i kësaj partie për kryetar të kësaj komune. "Mendoj se gjasat për t'u kthyer PDK-ja në pushtet në Prizren janë të mëdha. Kur e them këtë,

## Ambasadorja e Holandës vlerëson punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, ka pritur të martën në takim ambasadorën e re të Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Carin Lobbezoo, me të cilën ka diskutuar për punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe përparimin e arritur në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë, kontrollin e deklarimit të pasurisë dhe forcimin e mekanizmave në

parandalimin dhe luftimin sa më efikas të korrupsionit në Kosovë. Gjatë këtij takimi ambasadorja Lobbezoo ka vlerësuar punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe ka konfirmuar mbështetjen Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në drejtim të sundimit të ligjit dhe fuqizimin e rolit të Agjencisë në përpjekjet e përbashkëta kundër korrupsionit. Agjencia Kundër Korrupsionit vite me

radhë ka përfituar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës përmes programit MATRA dhe projekteve të ndryshme me qëllim parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe organizimin e ngjarjeve të shumta. Në këtë takim, ambasadorja Lobbezoo ishte e shoqëruar nga Venera Ramaj, zyrtare e lartë për sundim të ligjit në kuadër të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.



bazohem në disa faktorë siç janë: përkrahja që unë e kam nga partia, duke përfshirë këtu edhe bashkëpunimin e mirë brenda Degës së PDK-së në Prizren, kualitetin e resurseve humane që e kemi brenda PDK-së në qytetin e Prizrenit, përfshirë këtu edhe degën e Zhurit dhe të Hasit”, ka deklaruar Totaj.

**“Epoka e re”:** Z. Totaj, në zgjedhjet e 14 shkurtit PDK-ja është renditur partia e dytë me mbi 17 për qind të votave. Cili është vlerësimi juaj për këtë rezultat?

**Totaj:** Sinqerisht nuk kemi pritur se mund të fitojmë. E kemi pritur, ndoshta, këtë radhitje, por jo kaq dallim të madh në rezultat në mes të partisë së parë dhe të dytë. Mendoj se shkaqet që e kanë kushtëzuar, mënyra dhe shpejtësia se si është arritur ky rezultat, e bëjnë të njëjtin të paqëndrueshëm, sepse nuk është kjo gjendja reale. Shikuar në një afat pak më të gjatë kohor, mund të ketë qenë gjendje apo disponim i çastit i elektoratit. Më shumë kujdes po i kushtojmë rënies së numrit të votave sesa faktit që nuk kemi dalë partia e parë. Sidoqoftë, ne e kemi pranuar këtë rezultat si alarm që të fillojmë të mendojmë, si, çka dhe pse ndodhi, sidomos fokusi çka tani?

**“Epoka e re”:** Çfarë mendoni se ka ndikuar në këtë rënie të PDK-së?

**Totaj:** Mendoj se dy grupe të shkaqeve kanë ndikuar. Së pari si shkaqe të jashtme kanë qenë ambienti i krijuar në Kosovë dhe një eufori në krijimin e së cilës kanë kontribuar shumë faktorë, më shumë ose më pak relevantë, dhe assesi jo vetëm PDK-ja. Këtu vlen të theksohen edhe demagogjia dhe populizmi i LV-së, i cili personalisht besoj se është i dëmshëm dhe, si i tillë, shpejt do të demaskohet nga zhvillimet në të ardhmen e afërt duke i zhgënjyer kështu votuesit që presin shumë. Së dyti, kanë qenë shkaqet e

brendshme sikurse janë qëndrimi i gjatë në pushtet i cili e konsumon çdo parti, ngecja apo vonesa në reforma të cilat kishin filluar, por u ngadalësuan, mosadresimi me kohë dhe në mënyrë të duhur i dukurive negative për të cilat PDK-ja akuzohet shpesh pa të drejtë. Po ashtu, mund të them se edhe menaxhimi joadekuat i resurseve humane të shumta dhe kualitative që i ka PDK-ja, mosmarrje seriozisht e mendimit kritik i cili nuk them se nuk ka ekzistuar brenda PDK-së.

**“Epoka e re”:** Rezultati ka nxitur disa reagime të brendshme partiake, duke kërkuar marrje të përgjegjësisë nga lidershpi i partisë. Si i keni parë këto reagime?

**Totaj:** Reagimet e tilla tregojnë se PDK-ja është parti e hapur dhe brenda saj ka liri dhe hapësirë për të shprehur mendim ndryshe. Të gjitha diskutimet e kësaj natyre personalisht besoj se kanë për qëllim vetëm avancimin dhe ngritjen e PDK-së dhe, besoj se, ashtu do të ndodhë. Ne aktualisht jemi në proces të analizave të shkaqeve, pastaj do të kemi edhe konkluzione si dhe rekomandime se si do të veprojmë në të ardhmen. Ajo që mund të them tani është se askush brenda partisë nuk ik nga llogaridhënia, por ne aktualisht po e bëjmë identifikimin e fushave ku kemi mundësi për përmirësim, me qëllim të ngritjes së performancës e jo me qëllim të kërkimit të përgjegjësisë, aq më pak në një kontekst të fjalës “përgjegjësi” e cila, ndoshta, t’i kujton kohët e kaluara. Diskutime brenda forumeve partiake zhvillohen me ton pozitiv dhe konstruktiv dhe e them në kuptimin e plotë të fjalës, se ne jemi kritikë ndaj vetes, por vetëm në drejtim të identifikimit të proceseve dhe dukurive negative.

**“Epoka e re”:** Çfarë duhet të ndryshojë kjo parti për t’u rikthyer në zgjedhjet lokale që do të mbahen në vjeshtë?

**Totaj:** Mendoj se disa prej

shkaqeve, sidomos ato të brendshme, që e kanë kushtëzuar krijimin e kësaj gjendje e që u listuan më lart, duhet të eliminohen. Kur e them këtë kam parasysh: ngritje në cilësi të menaxhimit të resurseve humane partiake, mos të ketë vonesa në vendimmarrje dhe të ketë nominimin/formalizim të shpejtë të kandidatëve, sidomos në ato komuna ku nuk ka dilema rreth emrave, sepse kështu kandidatëve do t’u mundësohej të kenë kohë të mjaftueshme në dispozicion për t’u përgatitur, bashkërenditje të të gjitha angazhimeve partiake në një drejtim dhe në përkrahjen serioze për kandidatën e dominuar, fokusim në ato komuna ku PDK-ja, le të themi, tradicionalisht ka përparësi dhe rrjedhimisht gjasa për t’i fituar zgjedhjet lokale. Duhet theksuar se

rezultati i zgjedhjeve nacionale nuk është tregues real i disponimit të elektoratit, sepse në zgjedhje lokale votohet me logjikë tjetër krahasuar me zgjedhjet nacionale, andaj edhe rezultatet nëpër komuna do të jenë krejt ndryshe.

**“Epoka e re”:** A do të kandidoni për kryetar të Prizrenit në zgjedhjet lokale?

**Totaj:** Po, unë do të jem kandidat i PDK-së për kryetar të Prizrenit në zgjedhjet lokale që pritet të mbahen në tetor të vitit vijues. Pritet koha e duhur dhe kandidatura ime do të zyrtarizohet apo formalizohet sepse ajo tashmë veç është e shpallur.

**“Epoka e re”:** Sa janë gjasat që ta riktheni qeverisjen e PDK-së në këtë qytet?

**Totaj:** Mendoj se gjasat për t’u kthyer PDK-ja në pushtet në

Prizren janë të mëdha. Kur e them këtë, bazohem në disa faktorë sikur që janë: përkrahja që unë e kam nga partia, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin e mirë brenda Degës së PDK-së në Prizren, kualitetin e resurseve humane që e kemi brenda PDK-së në qytetin e Prizrenit, përfshirë këtu edhe degën e Zhurit dhe Hasit, për shkak të skandaleve të shumta, pakënaqësinë e qytetarëve të Prizrenit me keqqeverisjen e LV-së prej se kanë ardhur në pushtet lokal, përvojën që unë e kam krijuar në politikë prej se jam kyçur. Mendoj se është me rëndësi të theksohet se ne jo vetëm që do të kthehemi në pushtet, por kur të kthehemi do të implementojmë qeverisje shumë më kualitative se që qyteti ka parë deri më tani ndonjëherë, sepse i kemi të gjitha parakushtet që një gjë e tillë të ndodhë.



## Grenelli i reagon Kurtit, e quan antiamerikan

**PRISHTINË, 2 MARS** - Ish-emisari special amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka reaguuar pas qëndrimit të fundit të liderit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, rreth lokacionit të Ambasadës së Kosovës në Jerusalem. Grenelli përmes një postimi në

“Twitter” e ka quajtur Kurtin antiamerikan pasi, siç ka thënë ai, Kurti është kundër politikave të ShBA-së të sugjeruara nga ish-presidentët e saj. “Lideri i ri i Kosovës, majtisti antiamerikan, Albin Kurti, ka qenë kundër politikave të ShBA-së të sugjeruara nga Bill Clinton, George

Bush, Barack Obama dhe Donald Trump. Ai gjithmonë është antiamerikan”, ka shkruar Grenelli. Ai, po ashtu, thotë se ekipi i Bidenit duhet ta ndalojë këtë, duke cituar këshilltarin e sigurisë kombëtare të presidentit Joe Biden, Jake Sullivan.



## Tetë të vdekur dhe 488 raste të reja me Covid në Kosovë

Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të martën edhe 488 raste me Covid-19 pas testimit të 2 886 mostrave në institucionet publike dhe ato private. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK), më 2 mars janë regjistruar edhe tetë viktima



PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 2 886 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 488 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi. Rastet e vdekjes


janë nga komunat: Prishtinë katër raste (81, 77, 65, 78 vjeç), Klinë një rast (64 vjeç), Pejë një rast (37 vjeç), Prizren një rast (77 vjeç), Suharekë një rast (87 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 70 185 raste nga 313 132 persona të

dyshim të me këtë virus dhe 1 616 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 270 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 60 333 raste, kurse numri i rasteve aktive është 8.236. Rastet pozitive janë

nga komunat: Prishtinë 285 raste, Gjilan 47 raste, Fushë-Kosovë 35 raste, Gjakovë 20 raste, Pejë 17 raste, Kamenicë 11 raste, Lipjan 11 raste, Prizren 11 raste, Deçan 6 raste, Drenas 6 raste, Suharekë 5 raste, Malishevë 4 raste, Rahovec 4

raste, Viti 4 raste, Ferizaj 3 raste, Klinë 3 raste, Skenderaj 3 raste, Istog 2 raste, Kaçanik 2 raste, Mitrovicë 2 raste, Novobërdë 2 raste, Obiliq 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Podujevë dhe Vushtrri.

## Rreth 10 000 pako me fletëvotime nga diaspora kanë arritur pas afatit të caktuar nga KQZ-ja



PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Kryeshefi i Sekretariatit i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Burim Ahmetaj, ka bërë me dije se në adresë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë arritur rreth 10 mijë pako me fletëvotime, pas afatit që ishte caktuar nga ky institucion për dërgimin e këtyre pakove. Ahmetaj ka thënë se tërheqja e këtyre pakove nga postat përkatëse është bërë me qëllim që të ruhen të dhënat personale të votuesve. "Sekretariati i KQZ-së ka pranuar pako të supozuara me

fletëvotime edhe pas afatit të caktuar, që është mbyllur më 12 shkurt 2021. Tërheqja e këtyre pakove është bërë me qëllim të ruajtjes së të dhënave personale. Tërheqja është bërë më 18 dhe 19 shkurt, ku janë tërhequr nga posta e shpejtë DHL 691 pako dhe 27 pako ditën tjetër. Dhe, nga fahu postal janë tërhequr më 25 shkurt 9 030 pako. Gjithsej 9 748 pako janë të vendosura në depon e KQZ-së. Këto tërheqje kanë ndodhur më 18, 19 dhe 25 shkurt", ka bërë me dije Ahmetaj gjatë mbledhjes së KQZ-së.

## Shtohet bashkëpunimi i ShSKUK-së me Policinë e Kosovës

Prishtinë, 2 mars (ER) - Dr. Valbon Krasniqi, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, ka pritur në takim Samedin Mehmetin, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Në këtë takim u

diskutua për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe për mundësinë që ShSKUK-ja në të ardhmen t'i kryejë vizitat shëndetësore sistematike për policët e Kosovës. Drejtori Krasniqi ka

theksuar se, pavarësisht prej kohës së pandemisë, me sukses janë kryer vizitat e rregullta kontrolluese për kadetët e rinj të policisë, bazuar në memorandumun e bashkëpunimit që është nënshkruar në muajin shtator të vitit 2020 me

Policinë e Kosovës. Drejtori i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti ka falënderuar drejtorin e ShSKUK-së që edhe në kohë të pandemisë, ka ofruar bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme për Policinë e Kosovës. Të



dyja palët u pajtuan që bashkëpunimi i nisur në vitin 2020, të vazhdojë edhe këtë vit.

# Protestohet kundër 'uzurpimit të vendeve të garantuara' në Kuvendin e Kosovës

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 MARS - Me moton "Demokracia ka dështuar", përfaqësuesit e komuniteteve joserbe në Kosovë kanë marshuar të martën në qendër të Prishtinës, për të kundërshtuar, siç kanë thënë, "uzurpimin e vendeve të garantuara" në Kuvendin e Kosovës. Kjo protestë është thirrur nga 'Nasha Iniciativa' (Iniciativa jonë), parti e komunitetit boshnjak, e cila ka garuar në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit.

Osman Xhuxheviq, zëdhënës i kësaj iniciative, ka thënë se uzurpimi i vendeve të garantuara vjen si pasojë e një "procesi të mashtrimit elektoral" që, sipas tij, e pamundëson "përfaqësimin efektiv të komuniteteve joshumicë në Kuvendin e Republikës së Kosovës". "Komunitetet joshumicë kanë marrë pjesë në ndërtimin e shtetësisë së Kosovës dhe shoqërisë së lirë të Kosovës. Për këtë arsye, Kushtetuta e Kosovës u siguron të drejta atyre për t'ua mbrojtur identitetin dhe për t'ua garantuar mbijetesën, me qëllim të ruajtjes së diversitetit dhe multietnicitetit. Ajo që po

ndodh tani, është një shkelje e dukshme e këtyre parimeve, ku të drejtat kushtetuese të komuniteteve joshumicë sfidohen drejtpërdrejt dhe mbijetesat e tyre vihet në pikëpyetje", ka thënë Xhuxheviq. Ai ka paralajmëruar se komunitetet joshumicë do t'i përdorin të gjithë mekanizmat ligjorë për ta adresuar këtë çështje, por ka kërkuar që edhe institucionet e Kosovës t'u ndihmojnë.

"Ftojme institucionet relevante dhe komunitetin ndërkombëtar të reagojnë dhe të përkujdesen që parimet dhe fryma kushtetuese të mirëmbahen dhe të respektohen", ka thënë Xhuxheviq.

Partitë boshnjake në Kosovë që kanë garuar në zgjedhjet e 14 shkurtit, por shumica prej tyre kanë mbetur jashtë Kuvendit, kanë thënë se në zgjedhje, dy parti të reja, një nga komuniteti boshnjak dhe një nga rom, kanë fituar vota me ndihmën e Listës Serbe, përkatësisht të votuesve në komunat me shumicë serbe. Sipas tyre, partia Komuniteti i Bashkuar i Adrijana Hoxhiqit, nga komuniteti boshnjak, dhe Iniciativa Rome e Gazmend Salijeveviqit kanë fituar vota në vende ku nuk ka banorë të këtyre komuniteteve.



Partitë boshnjake kanë paralajmëruar se për këtë çështje, pasi të certifikohen rezultatet e zgjedhjeve, do t'i drejtohen Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, por edhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Nëse këto dy nivele nuk e adresojnë këtë çështje, ato kanë

paralajmëruar se do t'i drejtohen edhe Gjykatës Kushtetuese. Sipas Kushtetutës së Kosovës, komuniteti boshnjak i ka të garantuara tri ulëse në Kuvendin e Kosovës. Ende nuk dihet nëse Hoxhiq ka fituar një apo dy nga këto ulëse, pasi numërimi i votave nga

zgjedhjet e 14 shkurtit po vazhdon.

Komuniteti rom, ndërkaq, e ka të garantuar një ulëse në Kuvendin e Kosovës.

Hoxhiq, ndonëse ka pranuar se ka marrë vota nga mjediset me shumicë serbe, ka hedhur poshtë akuzat se ato i janë siguruar nga Lista Serbe.

## Beqiri: Zgjedhjet e brendshme në LDK mos të kontrollohen nga kryesia e partisë

PRISHTINË, 2 MARS - Xhavit Beqiri, ish-këshilltar politik i kryeministrit në detyrë, Avdullah Hoti, në një intervistë për "Telegrafin", ka folur për zhvillimet e fundit në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Beqiri ka thënë se brenda LDK-së ka nevojë për ndërrim brezash dhe jo për reformë konceptuale. Sipas tij, zgjedhjet e fundit në vend ishin një sinjal shumë i rëndësishëm që elektorati i LDK-së kërkon ndërrim të ekipit dhe prijësit të saj. "Partitë e spektrit të djathtë, ku bën pjesë edhe LDK-ja, duhet t'i përmbahen origjinalitetit të saj. Nuk ka nevojë për reformë konceptuale, më shumë ka nevojë për ndërrim brezash nëse merren parasysh rezultatet në zgjedhjet e fundit në Kosovë. LDK-ja nuk ka nevojë të ndryshojë asgjë në frymën e saj origjinale, mirëpo zgjedhjet e fundit ishin një

sinjal shumë i rëndësishëm që elektorati i LDK-së kërkon ndërrim të ekipit dhe prijësit. Është logjike që një subjekt politik të pësojë humbje...", ka thënë ai.

I pyetur se ku "çaluan" ish-kryetari i LDK-së dhe të tjerët nën udhëheqjen e LDK-së, ai tha: "Me gjasë elektoratit të LDK-së nuk i kanë pëlqyer eksperimentet e shumta të udhëheqësisë, sidomos me koalicionet e fundit. Natyrisht mund të ketë ndikuar edhe shkëputja e një pjese, të ish-kandidates së LDK-së për kryeministre në zgjedhjet e parafundit, Vjosa Osmani. Janë një varg faktorësh të cilët duhet të shihen me kujdes".

Beqiri tha se ka nevojë për reflektim të brendshëm dhe, siç tha ai, kryetari i ri i LDK-së duhet të takohet me elektoratin e saj, duke filluar nga nëndegët dhe degët saj. Ai tha se në të ardhmen në zgjedhjet e brendshme të LDK-së nuk duhet të ndiqen



praktikat e kaluara nga kryesia e saj. "Duhet të analizohen me gjakftohtësi të gjitha gjërat dhe të shihet programi për të ardhmen. Për mua nuk është e ngutshme një rikthim i

shpejtë, por duhet të bëhet një rishikim i përgjithshëm në tërësinë e saj... Mos të ndiqen praktikat e mëparshme që zgjedhjet e brendshme në LDK në një farë mënyrë të

kontrollohen dhe të instruktohen nga kryesia e partisë, sepse po del që kjo politikë e udhëheqjes nuk ka qenë e qëlluar", u shpreh Beqiri.

# Besëlidhja e Lezhës bën bashkë shqiptarët nga Kosova, Shqipëria, Mali Zi, Maqedonia dhe Lugina

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**LEZHË, 2 MARS** - Besëlidhja e Lezhës të martën ka shënuar 577-vjetorin. Në këtë përvjetor ka marrë pjesë kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, deputeti shqiptar nga Lugina e Preshevës në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, kryetar i Tuzit në Mal të Zi, Ziadin Sela, kryetari i Aleancës për Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut dhe Oliana Moriseni, nënkryetare e Bashkisë së Lezhës.

Kryetari i LV-së, Albin Kurti, para të pranishmëve është shprehur se Besëlidhja e Lezhës ishte akt politik, publik dhe kolektiv i lidhjes së shqiptarëve. "Sot, teksa shënojmë përvjetorin e besëlidhjes, që është akt politik, publik e kolektiv i lidhjes së dëshirës së

të mendonin e vepronin nga Skënderbeu e deri te rilindësit tanë e dëshmorët e luftës së fundit në Kosovë. Populli shqiptar duhet të faktorizohet", ka thënë Kurti.

Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka thënë se është nder i veçantë që është i pranishëm në shënimin e këtij përvjetori. "Është nder i veçantë për shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe për mua personalisht, që sot të marr pjesë në shënimin e 577-vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës. Si ngjarje themelore e historisë sonë, Lidhja e Lezhës është padyshim referencë e sotme për të ardhmen. Para më se pesë shekuj, në këtë vend, menduan qëllime dhe morën vendime aktuale edhe sot. E kush më shumë se shqiptarët e Luginës së Preshevës, vuajnë sot më shumë nga mungesa e jetësimit të qëllimeve dhe



përbashkët me veprimin e secilit, ne duhet të mendojmë e veprojmë duke menduar sesi do

idealeve të Besëlidhjes së Lezhës. Të shtypur dhe të diskriminuar nga shteti i

Serbisë. Të harruar ose instrumentalizuar nga politikanët në Tiranë dhe në

Prishtinë. Shqiptarët e Luginës së Preshevës nuk po trajtohen si shtetas dhe qytetarë të barabartë, me gjithë procesin e anëtarësimit të Serbisë në Bashkimin Evropian i cili i ka mbyllur sytë ndaj politikës autoritare, antiminoritare dhe antishqiptare, të pushtetit absolut të Aleksandër Vuçiqit", ka thënë Kamberi.

Ndërkaq kryetari i Tuzit, Nik Gjeloshaj, ka pohuar se kjo është një ngjarje historike. "Kam kënaqësi të veçantë që ndodhem në mesin tuaj. Kjo është një ngjarje historike, sepse kemi mbijetuar si popull. Gjuha, flamuri dhe kultura janë trimëria jonë e shenjtë dhe ato të ruhen me dinjitet. Ne së bashku kemi hapësirë të madhe për ta ruajtur gjuhën dhe traditën tonë", ka deklaruar Gjeloshaj.

Kryetari i Aleancës për Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, Ziadin Sela, ka theksuar

kjo ditë është shumë e rëndësishme. "Periudha për të cilën flasim ishte periudha e lavdisë së shqiptarëve, lavdi të cilën e ndërtoi me shumë mund e sakrificë, Skënderbeu, Gjergji ynë i dashur, Kuvendi i Lezhës është mesazhi që u la shqiptarëve për të ardhmen. Ishte ky Kuvend ai i cili e ndërtoi edhe Lidhjen e Prizrenit dhe ishte Lidhja e Prizrenit që hodhi gurtëmelin dhe idetë themelore të një shteti shqiptar të mëvetësishëm", ka thënë Sela.

Nënkryetarja e Bashkisë së Lezhës, Oliana Moriseni, ka thënë se Lezha është shtëpia e çdo shqiptari. "Lezha është shtëpia juaj dhe e çdo shqiptari. Qarku i Lezhës çdo vit mirëpret shqiptarë nga të gjitha trevat. Sot është ditë e Besëlidhjes së Lezhës. Pas kaq shumë shekujsh, kemi nevojë për një besëlidhje kombëtare", ka thënë Moriseni.





## “UBT”-ja mundëson analizat mikrobiologjike të ushqimeve



PRISHTINË, 2 MARS (ER) - UBT në Parkun Shkencor Inovativ ka Laboratorin e Mikrobiologjisë Ushqimore, i kompletuar me të gjitha standardet ndërkombëtare që mundëson kryerjen e testeve laboratorike në aspektin mikrobiologjik. Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve nga rreziku i agjentëve mikrobiologjikë, Laboratori i Mikrobiologjisë

Ushqimore UBT mundëson analizat ushqimore për qumështin dhe produktet e qumështit, mishin dhe produktet e mishit, ujërat e pijes dhe industriale etj. Laboratori i Mikrobiologjisë Ushqimore UBT kryen analizat mikrobiologjike të ushqimeve të ndryshme të cilat tregojnë se a janë të përpunuara ose jo dhe se a janë gati për konsum, si dhe bëhen analiza

bakterologjike dhe analiza mykologjike. Ky laborator mundëson edhe zhvillimin e veprimtarive kërkimore në fushën e shkencave të ushqimit dhe bioteknologjisë me të gjitha pajisjet e nevojshme, në mënyrë që studentët ta kenë më të lehtë punën praktike në këtë laborator.

Për ta kompletuar ekosistemin në fushat e shkencave të ushqimit dhe bioteknologjisë,

UBT ka ndarë një hapësirë të veçantë për disa parcela ku janë ndërtuar serra të tipit shkollor, në mënyrë që studentëve t'u krijohej një ambient atraktiv, praktik dhe motivues për mësim në fushat përkatëse e që janë mbjellë produkte bujqësore.

Të ndërlidhura me teknologjinë, në këto serra UBT është duke kultivuar qindra bimë të perimeve të llojit të

domateve trangujve dhe specave. Kësisoj, serra është duke shërbyer si një laborator fushor ku po prodhohen produkte për eksperimente të ndryshme që shfrytëzohen nga studentët dhe stafi akademik, nga ku rezultatet e fituara do të përcillen në sektorin e prodhimit si produkt i UBT-së për përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve bujqësore.

## Sami Mazreku emërohet drejtor i Byrosë Kosovare të Sigurimit



PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Asambleja e Përgjithshme e Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) ka emëruar Sami Mazrekun për drejtor të përgjithshëm të BKS-së për një mandat katërvjeçar, respektivisht deri më 28 shkurt të vitit 2025. Mazreku gjatë

pesë muajve të fundit ka ushtruar pozitën e ushtruesit të detyrës të drejtorit të BKS-së, derisa para se të vijë në këtë pozitë ai ka qenë edhe drejtor në Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës, derisa pjesë e sektorit të sigurimeve është që rreth 15 vjet.

Përndryshe, Mazreku ka të përfunduar Fakultetin Juridik në Prishtinë. Ai, gjithashtu, përfunduar studimet master, drejtimi Menaxhment dhe Lidership në Prishtinë, derisa studimet e doktoratës i ka përfunduar në Universitetin Uni-Bit në Sofje të Bullgarisë.

## Procedohet pagesa prej 3 milionë eurosh për Trepçën

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Më datë 16 shkurt 2021, ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka nënshkruar me

Trepçën marrëveshjen për ndihmë financiare, për subvencione dhe për investime kapitale, në shumën prej 3 milionë

eurosh. Me këtë rast, punëtorët e Trepçës të martën kanë marrë pagat e tyre. “Qeveria e Kosovës në vazhdimësi ka ndihmuar

Trepçën. Në nëntor të vitit të shkuar qeveria kishte ndarë 1.1 milion për këtë ndërmarrje”, ka njoftuar MEA.



## Drenasi, shembull i suksesshëm për legalizimin ndërtimeve pa leje

**DRENAS, 2 MARS (ER)** - Drejtresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në Drenas, Flutura Avdiu, bashkë me grupin punues për legalizimin e ndërtimeve pa leje, priti në takim përfaqësuesin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Ilir Kryeziu dhe përfaqësuesin e USAID-it, Vigan Perani.

Drejtresha Avdiu i njoftoi lidhur me procesin dhe rezultatet e legalizimit të ndërtimeve pa leje në

Komunën e Drenasit. Në anën tjetër, Kryeziu nga MEA dhe Perani nga USAID-i, pasi u njoftuan për të gjitha veprimet e ndërmarra nga Komuna e Drenasit, përgëzuan për punën e bërë në këtë proces, njëherësh vlerësuan Drenasin si shembull të suksesshëm, që duhet të ndiqet nga komunat e tjera. Po ashtu, ata u njoftuan lidhur me broshurën e përgatitur për qytetarët, ku informohen në detaje lidhur me procedurat për legalizimin

dhe dokumentacionet e nevojshme, duke sugjeruar që kjo broshurë të merret si mostër se si duhet hartuar komunat e tjera.

Në këtë takim u diskutua rreth procesit të deritanishëm që ka kaluar Komuna e Drenasit rreth legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje, arritjet, sfidat dhe paqartësitë në këtë drejtim, ndërsa u informua se së shpejti do të nisin edhe takimet nëpër vendbanimet e Drenasit, të cilat janë shtyrë për shkak të pandemisë.



## Drejtori i Inspektionit në Gjakovë inspekton ndërtimet në këtë komunë



**GJAKOVË, 2 MARS (ER)** - Drejtori për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës, Fazli Hoxha, ka dalë të martën në terren për t'i inspektuar objektet e ndërtimit në këtë komunë. Hoxha, i shoqëruar edhe nga inspektorët e ndërtimit, ka parë nga afër se sa po respektohen lejet e ndërtimit në Komunën e Gjakovës. Ai ka theksuar se ndërtimet janë duke u bërë në

harmonizim me procedurat ligjore të ndërtimit. Hoxha ka paralajmëruar se ata të cilët nuk i respektojnë lejet e ndërtimit do të merren masa, ashtu siç e parasheh Ligji i ndërtimit. "Së bashku me inspektorët e ndërtimit dolëm në terren për t'i inspektuar objektet në ndërtim e sipër në Komunën e Gjakovës. Nuk vërejtëm asnjë parregullsi në ndërtimet të cilat janë duke u

kryer në pajtim me lejen ndërtimore. Si Drejtori e Inspektionit do të angazhohemi që kjo gjendje stabile të vazhdojë kështu duke respektuar procedurat ligjore të ndërtimit. Në të kundërtën, do të merren masa të cilat i parasheh Ligji i Ndërtimit që inspektorët e ndërtimit janë të obliguar t'i ndjekin deri në fund", ka shkruar drejtori Hoxha në rrjetin social "Facebook".

## Testet e shpejta për Covid mund të kryhen edhe në Gjonaj, Reçanë, Korishë dhe Zhur

**PRIZREN, 2 MARS (ER)** - Drejtoria e Shëndetësisë në Prizren ka njoftuar se për shkak të rritjes së numrit të pacientëve, realizimi i testeve të shpejta (rapide) për Covid-19, përveç në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare në Bajram Curr, tanimë do të mund të kryhen edhe në QMF-të e fshatrave Gjonaj, Reçanë, Korishë dhe Zhur. Në këtë mënyrë, Drejtoria e Shëndetësisë synon të ulë intensitetin e punës në QKMF dhe QMF në Bajram Curr dhe,

po ashtu, t'i eliminojë lëvizjet e qytetarëve, eventualisht të prekur me Covid-19. Përveç këtyre testeve, Komuna e Prizrenit është një nga komunat e para në Kosovë që ka kompletuar pakon e shërbimeve për Covid-19, duke i realizuar edhe: Testet e D-Dimer-it, rëntgenin e mushkërive, analizat e tjera të nevojshme dhe testet aerologjike. DSh-ja u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të kujdesen për veten, familjen dhe miqtë e tyre duke mbajtur maskën, distancën dhe pastërtinë.




## Bulliqi përruroi ndriçimin publik në shtatë rrugë të Dumnicës

**PODUJEVË, 2 MARS (ER)** - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike, Fevzi Jetullahu, kanë përruruar rrjetin e ndriçimit publik në disa rrugë të fshatit Dumnicë. Në kuadër të investimeve në rregullimin e infrastrukturës dhe ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët, në

shtatë rrugë të fshatit Dumnicë është realizuar projekti i ndriçimit publik në një gjatësi të përgjithshme prej 7.3 km. Me rastin e përrurimit të rrjetit të ndriçimit publik në rrugët e Dumnicës, kryetari Bulliqi tha se në kuadër të investimeve kapitale, gjatë këtij viti do të investohet në projektet që kanë të bëjnë me sigurinë e

qytetarëve. "Realizimi i këtij projekti dhe projekteve të tjera të ndriçimit publik ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve", tha kryetari Bulliqi. Përveç ndërtimit të rrjetit të ndriçimit publik në Dumnicë, gjatë këtyre ditëve është bërë edhe ndërrimi i 68 trupave të ndriçimit publik në shtatë rrugë të qytetit në Podujevë.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Batatina: Llapi nëpërmjet Kupës siguron daljen në Evropë

Trajneri Tahir Batatina për "Epokën e re" ka thënë se Llapi synon daljen në Evropë nëpërmjet Kupës. "Nëse e shohim ecurinë pozitive të klubit dhe triumfin në tri ndeshje të forta, besoj se sikurse edhe në të kaluarën në stadiumin 'Fadil Vokrri' do të marrim rezultat pozitiv. Në këtë stadium ndihem sikurse luajmë në shtëpinë tonë, prandaj jemi të gatshëm ta japim maksimumin dhe t'i arrijmë qëllimit ndaj një klubi shumë të fortë dhe që po kalon formën më të mirë në ligë", ka deklaruar Batatina

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 2 MARS** - Skuadra e Llapit e nisi kampionatin 2020/2021 në mënyrën jo të mirë dhe rezultatet përgjatë sezonit vjeshtor nuk ishin ato që priteshin nga opinioni futbolldashës. Mirëpo kjo skuadër në pranverë ka ndryshuar dhe ka arritur të marrë rezultate pozitive, madje edhe ndaj kundërshtarëve shumë të fortë.

Trajneri Tahir Batatina të martën në bisedë për "Epokën e re" ka thënë se sekret i suksesit të klubit lllapan është ai vetë, për faktin se, pas përfundimit të sezonit vjeshtor, i mori të gjitha punët përdore dhe këto sollën edhe ndryshime. "Në sezonin vjeshtor përgatitjen e ekipit ia besova një trajneri të huaj. Moskomponimi i skuadrës siç duhet bëri që të mungojnë rezultatet. Në futboll faza përgatitore është shumë e rëndësishme dhe në pushim të gjitha punët i mora përsipër dhe kjo po sjell rezultate. Jam i kënaqur me ecurinë e skuadrës në pranverë dhe besoj fuqishëm se do të vazhdojmë me këtë ritëm", ka thënë Batatina.

Llapi në fundjavë e mposhti skuadrën e Ballkanit në kuadër të javës së 22-të në Superligë dhe ndeshjen e radhës e pret një derbi tjetër kundër Prishtinës në stadiumin "Fadil Vokrri". Batatina është optimist se Llapi edhe në këtë ndeshje do të dalë me rezultat pozitiv, ani pse kryeqytetasit janë skuadra më në formë për



momentin në ligë. "Nëse e shohim ecurinë pozitive të klubit dhe triumfin në tri ndeshje të forta, besoj se sikurse edhe në të kaluarën në stadiumin 'Fadil Vokrri' do të marrim rezultat pozitiv. Në këtë stadium ndihem sikurse që luajmë në shtëpinë tonë, prandaj jemi të gatshëm ta japim maksimumin dhe t'i arrijmë qëllimit ndaj një klubi shumë të fortë dhe që po kalon formën më të mirë në ligë", ka deklaruar Batatina.

Llapi është kualifikuar në çerekfinale të Kupës, ku më 17 mars do të përballlet me skuadrën e Trepçës '89. Trajneri Batatina ka thënë se skuadra që ai e drejton synon daljen në Evropë nëpërmjet kësaj gare. "Nuk kemi pse ta

mbajmë të fshehur, se synimi ynë është dalja në Evropë nëpërmjet Kupës. E kemi eliminuar në këtë garë një skuadër të fortë siç është Ballkani dhe tash jemi edhe më të motivuar që t'i shkojmë kësaj gare deri në fund. Lajm i mirë është rikthimi i portierit Nava dhe tash kemi tre portierë cilësorë në skuadër dhe ky është një plus i madh. Gjithashtu, potenciali i pjesës tjetër të futbollistëve është i madh", ka përfunduar Batatina. Skuadra e Llapit aktualisht pozicionohet në vendin e shtatë me 26 pikë të grumbulluara. Nga 22 ndeshje të zhvilluara, djelmohat e drejtuar nga Tahir Batatina kanë regjistruar 8 fitore, 2 barazime dhe 12 humbje.

## SHKURT

### Ndryshon termini i ndeshjes Ballkani - Drenica

Ndeshja e javës së 23-të e Superligës ndërmjet Ballkanit dhe Drenicës do të zhvillohet ditën e premtë, më 5 mars, në orën 13:00. Kjo ndeshje ishte paraparë të zhvillohej të dielën, mirëpo KF Drenica ka bërë kërkesë që të ndryshojë termini i kësaj ndeshje për shkak të manifestimeve të epopesë së UÇK-së, andaj Komisioni i Garave me pëlqim edhe nga klubi nikoqir, Ballkani, e ka miratuar kërkesën e klubit nga Skenderaj.

### Mediumi zviceran: Rashica në verë mund t'i bashkohet Leverkusenit

Milot Rashica ishte shumë afër transferimit te Bayer Leverkusenit në tetorin e vitit të kaluar, shkruan mediumi zviceran "Nau.ch". Marrëveshja ishte shumë afër që të bëhet, por dështoi. Sidoqoftë, pritet që në afatin kalimtar të verës së ardhshme, Werderi dhe Leverkuseni të tentojnë të pajtohen për marrëveshje rreth yllit të Kosovës. Në dy afatet e fundit kalimtare, lojtari më i përfolur për një largim të mundshëm nga Bremeni ishte 24-vjeçari që, njëkohësisht, është edhe lojtari më i vlefshëm në klub. Kontrata e Rashicës skadon në vitin 2022 dhe ka gjasa për ndërrim ambientit në verën e ardhshme.

### E ardhmja e Strakoshës, larg Lazios

E ardhmja e portierit të Kombëtares së Shqipërisë, Thomas Strakoshës, është një mister. Portieri kuqezi e ka humbur vendin e titullarit te Lazio dhe duket se aventura e tij me bardhekaltrit është afër fundit. Kontrata e Strakoshës skadon në vitin 2022 dhe, sipas "Radiosei", Lazio nuk ka ndërmend t'i ofrojë rinovimin.

### Laporta: Nëse unë nuk fitoj, Messi largohet nga Barcelona

Fushata për president te skuadra e Barcelona është duke u zhvilluar te televizionet më të njohura në Spanjë. Tre kandidatët Joan Laporta, Victor Font dhe Toni Freixa kanë kohë për ta shpjeguar programin e tyre për zgjedhjet deri më 7 mars. Më i qartë ka qenë Joan Laporta që ka prekur argumentin e së ardhmes së Lionel Messit. "Mund të jetë fakti që ne nuk mund të luftojmë në nivelin monetar, por Messi nuk drejtohet drejt parasë. Dëshiron ta mbyllë karrierën sportive sa më lart të jetë e mundur. Me Messin kam një marrëdhënie të mirë dhe respekti. Jam i bindur se nëse do të fitoj një kandidat tjetër, nuk do të vijojë te Barcelona", ka deklaruar Laporta.

## Pochettino: Mbappe do të jetë pasues i Messit dhe Ronaldos

Kylian Mbappe është tashmë në mesin e më të mirëve në botë dhe ende ka potencial për t'i pasuar Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldon, sipas Mauricio

Pochettino, trajnerit të Paris Saint-Germain. Sulmuesi francez i shënoi dy gola në fitoren e PSG-së 4-0 në udhëtim kundër Dijonit, duke e rritur epërsinë në renditjen e

golashënuesve më të mirë në Ligën 1. I pyetur nëse Mbappe mund të jetë pasues i Messit dhe Ronaldos në botën e futbollit, trajneri argjentinas ka deklaruar: "Ai ka potencial. Atij

nuk i mungon asgjë përveç kohës. Mbappe nuk mund ta përshejtojë procesin. Mendoj se ai është në mesin e më të mirëve në botë tashmë".

## Kampioni olimpik: Mungoj në Olimpiadë dhe nuk e marr vaksinën

KINGSTON, 2 MARS - Kampioni olimpik, Yohan Blake, ka thënë se është i gatshëm të mos marrë pjesë në Lojërat Olimpikë të Tokios për të mos marrë vaksinën kundër koronavirusit, edhe pse ky nuk është një detyrim nga

organizatorët e kompeticionit. "Mendoj vetëm ta ruaj forcën, nuk dua të marr vaksinën. Më mirë mungoj në Olimpiadë sesa ta marr vaksinën. Nuk e marr", ka thënë xhamajkani në një intervistë për gazetën

vendase "The Gleaner". "Nuk dua të merrem me këtë çështje tani, por kam arsytet e mia", ka shtuar ai. Blake, dikur rival i legjendës së atletikës, Usain Bolt, me siguri që do të ketë mundësi të marrë pjesë në Tokio 2021, që do të jetë

edhe olimpiada e fundit për të. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar ka njoftuar deri tani se marrja e vaksinës kundër koronavirusit është "e inkurajueshme", por jo e detyrueshme për sportistët pjesëmarrës.



## Muller: Ndashjet kundër Dortmundit janë si finale, titulli sërish i yni

MUNCHEN, 2 MARS - Nëse ekziston dikush që ka nisur ta shijojë rikthimin në skuadër, ai është pa dyshim Thomas Muller. Mesfushori gjerman i Bayernit luajti disa minuta në përballjen me Kolnin duke dhënë edhe asistim për skuadrën e tij në një nga pesë golat e shënuara. E hëna ishte ditë pushimi për skuadrën, por jo për Mullerin. Në një ditë me diell në qiellin e Mynihut, 31-vjeçari u shfaq i vetëm në qendrën stërvitore të shoqëruar nga trajneri i dytë. Vrapime, ushtrime, stretching dhe goditje në portë ishte programi i ditës. Ndërkohë, kjo nuk u kalua pa u vënë re nga pjesa tjetër e skuadrës e cila, edhe pse nuk zbriti në fushë, qëndronte në ambientet e klubit për fizioterapi.

Robert Lewandowski ishte një prej tyre i cili, i buzëqeshur, shihte teksa Muller djeriste dhe "vuante" i vetëm në fushë. Në mungesë të punëtorëve të fushës, Mullerit iu desh t'i mbante topat i vetëm, një skenë humorit e cila nuk u shpëtoi fotografëve dhe gazetarëve të cilët ndodheshin në ambientet e klubit. "Bild" e cilësoi stërvitjen



e Mullerit si një tregues i qartë i vullnetit dhe dëshirës që ai ka për të luajtur dhe shërbyer skuadrës. Covidi e la atë dy javë jashtë fushave duke i mohuar lojtarit pjesëmarrjen në finalen e Kupës së Botës për Klube. Por, Thomas është një luftëtar, i gatshëm të rikthehet në momentin më të rëndësishëm për skuadrën. Ndërkaq, lajmet për një rikthim në kombëtare sa vijnë dhe shtohen, duke marrë shkas edhe nga fjalët e trajnerit të kombëtares, Joachim Low, i cili u shpreh se kishte ardhur momenti që Mullerit të rikthehej në kombëtare për t'i sjellë skuadrës energji të reja. Këto fjalë para Evropianit i kanë

dhënë një impuls më shumë lojtarit i cili realisht do të ishte një armë më shumë për "Pancerat". Teksa klasikja me Borussia Dortmundin po afrohet, nuk mungoi edhe një batutë e ish-kampionit të botës, teksa po dilte nga fusha e stërvitjes: "Kundër Dortmundit është një ndeshje të cilën e luajmë si të ishte një finale. Sfidat tilla janë motivim për ne. Duam të tregojmë që jemi kampionët në fuqi dhe se titulli duhet të vijë sërish në Munchen në fund të sezonit". Mesazhi i Mullerit është i qartë, edhe në këtë përballje Bayerni është favorit për të fituar ndaj rivalit të përjetshëm në Gjermani.

## Brooklyni në shtesë e mposhti San Antonion

BROOKLYN, 2 MARS - Sukses historik për Brooklyn, që iu imponua San Antonio Spursit në kohën shtesë 113-124, në një fushë ku nuk fitonte prej 19 vjeetësh. Protagonist absolut i mbrëmjes me "triple-double", James Harden, i cili realizoi 30 pikë, 14 "rebounde" dhe 15 asistime, pa humbur as një top. Ndihmë të madhe në këtë sukses të Nets dha edhe Irvingu me 27 pikë, ndërsa "Spurs"-ave nuk u mjaftoi "double-double" i DeMar DeRozanit, që e mbylli takimin me 22 pikë dhe 11 asistime. Fitore surprizë 129-124 e New Orleans Pelicansit ndaj kryesuesve të Konferencës së Perëndimit, Utah Jazz. Dominues mbi parket Zion Williamson me 26 pikë e 10 "rebounde", por peshë të madhe pati edhe kontributi i Brandon Ingram me 26 pikë dhe i Lonzo Ball me 23 pikë. Në radhët e Jazzit realizoi 31 pikë Bojan Bogdanović, por që nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen e tretë në gjashtë përballjet e fundit, raporton "Supersport". Vijon momenti



pozitiv i Dallas Mavericksit, që fitoi ndaj Orlando Magicut me rezultatin 124-130. E rrëmbu skenën i zakonshmi Luka Dončić, që për pak realizoi "triple-double": 33 pikë, 10 "rebounde" dhe 9 asistime. Talenti sloven i udhëhoqi teksanët drejt suksesit të tetë në 10 ndeshjet e fundit. U kthye te fitorja Philadelphia 76ers, që triumfoi ndaj Indiana Pacersit 130-114, duke ruajtur kryesimin në Lindje. Spikati me "double-

double" Joel Embiid, autor i 24 pikëve dhe 13 "reboundeve", ndërsa Shake Milton shtoi 26 pikë të tjera për 76ers.

### Rezultatet

Orlando Magic - Dallas Mavericks	124-130
Philadelphia 76ers - Indiana Pacers	130-114
Chicago Bulls - Denver Nuggets	112-118
New Orleans Pelicans - Utah Jazz	129-124
San Antonio Spurs - Brooklyn Nets	113-124
	(shtesë)
Houston Rockets - Cleveland Cavaliers	90-101
Portland Trail Blazers - Charlotte Hornets	123-111

### SHKURT

#### Pronari i makinës Haas: Mercedesi e ka 'vrrarë' këtë sport

Prej vitesh jemi mësuar që në majën e Formula 1 ta shohim makinën Mercedes, që ka triumfuar në të gjitha sezonet, qëkur u aplikua motori hibrid. Gene Haas, pronari i makinës Haas në Formula 1, në një intervistë për "racer.com", u shpreh se ky dominim i makinës gjermane e ka shkatërruar këtë sport, që prej vitesh ka humbur bukurinë e rivalitetin në pistë. "Për mua, Mercedesi e ka 'vrrarë' apo shkatërruar këtë sport. Mercedesi ka një potencial të madh, duke dominuar në Formula 1. Për pasojë, asnjë nuk dëshiron të vijë për të parë një garë apo të ulet në TV, pasi dihet pa nisur gara se kush është fituesi. Kjo gjë e ka bërë sportin tonë të mërzhitshëm për publikun", ka thënë Haas, që është kundër këtij dominimi që ka nisur prej vitit 2014.

#### Ndërroi jetë legjenda e Liverpoolit

Bota e futbollit në zi. Legjenda e Liverpoolit, Ian St John, ka ndërruar jetë në moshën 82-vjeçare, i cili vuante prej një kohe të gjatë, nga një sëmundje e rëndë në prostë. Lajmi është konfirmuar nga vetë klubi i kuq, nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare. "Ne jemi shumë të pikëlluar nga vdekja e një legjende të vërtetë si Ian St John. Mendimet e të gjithëve në klubin e Liverpoolit janë me familjen dhe miqtë e Ian në këtë kohë të trishtuar dhe të vështirë", shkruhej në deklaratën ngushëlluese të klubit anglez. Ish-sulmuesi skocez kishte fituar dy tituj të ligës së parë nën urdhrat e Bill Shanklit në "Anfield" në sezonet 1963/64 dhe 1965/66, derisa kishte shënuar edhe golin fitues në finale të FA Cup në vitin 1965. John, gjithashtu, kishte përfaqësuar Skocinë 26 herë, derisa më vonë ai u bë trajner i klubit të tij të fëmijërisë, Motherwell, si dhe Portsmouthit.

#### Federeri tërhiqet nga Miami Open

Tenistët Roger Federer e Rafael Nadal kanë vendosur t'i ndryshojnë planet e tyre sezonale, duke zyrtarizuar mungesën në disa nga turnetë ku fillimisht kishin dhënë pëlqimin e pjesëmarrjes së tyre. Federeri, që këtë javë do të rikthehet në fushë pas 14 muajsh pushim në turneun e Doha, ka deklaruar se nuk do të marrë pjesë në turneun Masters të Miami. Ky është Mastersi i parë sezonal (22 mars-4 prill). Për pasojë, Federeri do të humbasë 1 000 pikë në renditje, duke qenë se është kampion në fuqi (ka fituar për herë të fundit në vitin 2019, ndërsa vjet ky turne nuk u zhvillua si pasojë e pandemisë). Edhe Rafael Nadali ka vendosur t'i ndryshojë planet e tij. Spanjollit është tërhequr në çastet e fundit nga turneun e Roterdamit, që ka nisur në Holandë këtë javë. Jo vetëm kaq, po Nadali do të mungojë edhe në turneun e Akapulko (Meksikë), që zhvillohet në mes të marsit. Sipas menaxherit të tenistit spanjoll, ky vendim u mor për arsye shëndetësore.

#### Zidane: Luajtëm mirë kundër Sociedadit, por lëshuam dy pikë

Real Madridi bëri hap fals duke barazuar në shtëpi ndaj Real Sociedadit me shifrat 1-1, duke i lënë Barcelonës vendin e dytë në renditje. Trajneri Zinedine Zidane foli për mediat dhe u kujdes t'i nënvizonte anët pozitive të ndeshjes, ani pse skuadra e tij lëshoi dy pikë. "Bëmë një ndeshje të mirë. Patëm raste të mira në pjesën e parë, por nuk arritëm të shënonim. Janë dy pikë të humbura në shtëpi, por përballë ishte një kundërshtar shumë i fortë. Ndryshimi i modulit? Nuk isha i kënaqur me presionin e skuadrës ndaj kundërshtarit. Pas 10-15 minutash u kthyem 4-3-3. Ndryshimet shkuan mirë në lojë. Derbi ndeshja e radhës? Nuk ndryshon mënyra e përgatitjes së ndeshjes. Luajmë ndaj të parëve në renditje", ka thënë Zidane.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kiesłowski, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowski dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

ÇMIMI: 5.99 €




AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIESŁOWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

「nga Moisiu deri te Kiesłowski」



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €




Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN


Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



**KOMUNA –SUHAREKË**  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale  
06-Nr- 568  
Me datë 02.03.2021

Në bazë të nenit 8. të paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr- 03/L-212, nenit 4 par.2 të Udhëzimit Administrativ(MPMS)nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Autorizimit të Kryetarit të Komunës,01-Nr.016-12698 të datës 22.02.2021, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë :

### KONKURS

**1 .Dy mjek/e të praktikës së përgjithshme në QKMF në Suharekë.**

**Numri i Referencës: 06- Nr. 568**

**Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës :**

- Kujdeset për shëndetin e pacientëve,përshkruan tretmanet,medikamentet dhe aplikon masat tjera shëruese;
- Udhëzon pacientët në bërjen e analizave bazike laboratorike dhe aplikon procedurat tjera diagnostike;
- Aranzhon bartjen e pacientëve në spital;
- Udhëzon pacientët tek specialistët mjekësor dhe shkëmben të dhëna relevante mjekësore;
- Pranon implementimin e programeve shëndetësore të dizajnuara në nivele më të larta si Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna;
- Ndihmon në preventimin e sëmundjeve ngjitëse dhe çrregullimeve të ndryshme duke u këshilluar në shëndetin bazik të përgjithshëm.

Kualifikimi : Të gjithë kandidatët duhet të kenë të kryer fakultetin e Mjekësisë,drejtimi i Mjekësisë së përgjithshme.

- Orari i punës: I plot;
- Paga: H-27,H-565/1
- Kohëzgjatja 6 gjashtë muaj punë me mundësi vazhdimi

**Kandidatët që aplikojnë duhet të sjellin këto dokumente;**


- Diplomën përkatëse mbi shkollimin e kryer;
- Vërtetimin mbi stazhin e kryer;
- Licencën e punës;
- Çertifikatën e lindjes;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën e gjendjes shëndetësore.
- Çertifikatën që ndaj tij/ asaj nuk zbatohen hetimet.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.


Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato që arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.


Të interesuarit formularin e kërkesës për punësim mund t'a marrin në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Suharekë.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes në mjetet e përditshme informative.**




Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe M.Sociale  
Ma.Sc. Besa KUQI





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



**KOMUNA –SUHAREKË**  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**Direkçija za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit**  
06. Br.568  
Datum: 02.03.2021

Na osnovu člana 8. stavova 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, člana 4. stav 2. Administrativnog uputstva (MRSZ) br.07 / 2017 o uređivanju postupaka Konkursa u javnom sektoru Opštine, 01-Br.016-12698 od 22.02.2021, Direkçija za zdravstvo i socijalnu zaštitu objavljuje:

### KONKURS

**1. Dva lekara opšte prakse OCPM**

Naznaka broj: **06- Br.568**

**Opis poslova i radnih obaveza:**

- Stara se o zdravlju,opisuje tretmane, lekove, i preuzima ostale mere za zdravstvenu negu pacijenata;
- Upućuje pacijente na osnovu laboratoriske analize i primenjuje ostale dijagnostičke procedure;
- Organizuje prenos pacijenata u bolnicu;
- Upućuje pacijente kod lekara specialiste i razmenjuje relevantne medicinske podatke;
- Prihvata sprovođenje zdravstvenih programa sastavljenih na višim nivoima, kao Ministarstvo Zdravlja i Opštine;
- Pomaze u prevenciji zarazne bolesti i razne poremećaje u skladu sa osnovama opšteg zdravstvenog stanja itd.

**Kvalifikacije:** Svi kandidati moraju imati završen Medicinski Fakultet – smer Opšte Medicine ;

- Puno radno vreme ;
- Plata : H-27,H-565/1
- Trajanje ugovora : 6 meseci probno sa mogućnosti produženja.

**Kandidati koji konkurisu moraju doneti sledeću dokumentaciju :**


- Diplomu o stručnom obrazovanju;
- Potvrdu da je završio/la praksu;
- Licencu za rad;
- Izvod rodenih;
- Fotokopiju lične karte
- Uverenje o zdravstvenom stanju
- Potvrdu da protiv njega / nje nije pokrenuta istraga.

Nepotpune prijave po uslovima konkursa i one koje su prispele po isteku roka, neće biti razmatrane.

Opština Suva Reka pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova, i rado očekuje aplikacije muških i ženskih osoba svih zajednica koje žive na Kosovu.


Svi zainteresovani, obrazac za prijavu mogu dobiti u Opštinskoj Direkçiji za Zdravstvo u Suvoj Reci.

**Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevni sredstvima javnog informisanja.**



Direktor, Direkçije, OCPM  
Ma.Sc. Besa KUQI







# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Agim Rashiti shpall të pavlefshme certifikatën e Veteranit në regjionin e Gjilanit.
- ▶ Valbon Gashi shpall të pavlefshme diplomën shmit "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Elmedina Kastrati shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Brigada 125 " Medvec.
- ▶ Blendon Kurtaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.
- ▶ Hamit Osaj shpalle të pavlefshme dëftesat e SHMLT "Anton Ceta"
- ▶ Myzafere Preteni shpall të pavlefshme diplomën e SHML " Dr xheladin Deda"
- ▶ Mimoza Voca shpallë të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Trepça".
- ▶ Selim Kelmendi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"
- ▶ Egzone Qazim Muharremi shpall të pavlefshme Diplomën Bachelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet në Universitetin e Prishtinë UP.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

## RESTAURANT



# SWISS

## TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

